



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e74-të, të mbajtur më 05.09.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-792/1 datë 04.02.2022, NDËRPRITET Prandaj, KSHPK-ja vërtetoi se organ tjetër është kompetent për të vepruar sipas pretendimeve nga denoncimi.

Lënda me numër 12-792 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-792/1 të datës 04.02.2022 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Pretendimet në denoncim i referohen aktiviteteve të zyrtarëve në Inspektoratin Shtetëror të Transportit të RMV-së, inspektorit, drejtorit të këtij Inspektorati, personit zyrtarë///, si dhe ish-sekretarit të përgjithshëm të qeverisë së RMV-së, personit zyrtarë///. Theksohet se ekziston dyshimi se disa persona nuk janë të punësuar në inspektorat dhe me përfaqësim të rremë po shantazhojnë transportuesit dhe po paguajnë një shumë për t'u lëshuar licencat dhe lejet e nevojshme, si dhe se inspektori i specifikuar ka pasur lidhje familjare me ish Sekretarin e Përgjithshëm të Qeverisë së RMV-së. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në të njëjtën kohë, denoncimi iu dorëzua Këshillit Inspektues të RMV-së, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Kryeministrit të Qeverisë së RMV-së, Zëvendëskryeministrit për luftën kundër korrupsionit dhe krimin, zhvillimit të qëndrueshëm dhe burimeve njerëzore, si dhe Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve të RMV-së. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Pas inspektimit të përmbajtjes së raportit, KSHPK-ja u ka dorëzuar të gjitha institucioneve të përmendura më parë një kërkesë për njoftim nëse janë ndërmarrë ndonjë aktivitet nën juridiksionin e tyre në lidhje me pretendimet e përmendura në denoncim. Nga të dhënat dhe informacionet e marra, u konstatua se Këshilli Inspektues ia ka përcjellë shkresën MPB-së, Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë, me urgjencë të KSHPK-së, e cila ka raportuar

se kërkesa e mëparshme nuk është evidentuar në arkivin e tyre. Vetëm Njësia për Krime Ekonomike dhe Kompjuterike në MPB të RMV-së raportoi se janë marrë masa për zbardhjen e rastit dhe deri në PTHP, është dorëzuarë njoftimi me shkrim nr. /// e vitit ///. Pas vlerësimit të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rastit në fjalë, Ministria e Punëve të Brendshme e RMV-së dhe pas provave të siguruara do t'i dorëzojë parashtruesën përkatëse kësaj prokurorie për veprime të mëtutjeshme.

Në bazë të kushteve të konstatuara, përkatësisht se organi tjetër kompetent është duke vepruar sipas pretendimeve nga denoncimi i parashtruesit, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: K.N.

КОМИСИОНИ СХТЕТЁРОРЁ
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
КРЬЕТАРЕ,
Biljana Ivanovska